

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR



"MEDIASHOP" SH.P.K.

Ne vitin njemije e nenteqind e nentedhjet e tete, ne daten 24 te muajit Mars, ne Tirane une i quajturi Ardian Mullahi, lindur me 30.01.1966 ne Tirane, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, shpreh deshiren dhe vullnetin tim te lire per te themeluar nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar me kushtet si me poshte vijon:

Ne mbeshtetje dhe zbatim te dispozitave te ligjit nr. 7638, dt. 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te quajtur "MEDIASHOP" Sh.p.k, ku une do te jem Ortak i Vetem.

Kapitali themeltar i saj do te jete 100.000 (njqindmije) leke i ndare ne 100 (njqind) pjese te barabarta nga 1.000 (njemije) leke sejcila, i formuar krejtesisht nga une Ortaku i Vetem.

Kapitali themeltar do te depozitohet ne Banken e Kursimeve te Shqiperise, Dega Tirane.

Objekt i veprimtarise do te jete:

Ushtrimi aktivitetit ne fushen e publicitetit qe nenkupton pergatitjen dhe shperndarjen e materialeve publicitare ne te gjitha fushat e medias te shkruar dhe elektronike, si dhe prodhimi e tregtimi i reklamave dhe materialeve te ndryshme audio - vizive.

Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise do te jete per nje periudhe te pakufizuar por jo me pak se 10 vjet.

Selia administrative e shoqerise do te jete Tirane.

Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator i Vetem detyren e te cilit do ta kryej Une Ardian Mullahi, lindur me 30.01.1966 ne Tirane, banuese ne Tirane, "Qemal Stafa", Pall.341, Sh.4, Ap.48 dhe do te kem te drejta, detyra dhe kompetenca sipas percaktimit te bere ne statutin e kesaj shoqerie dhe ne dispozitat ligjore ne fuqi.

THEMELUESI


Ardian Mullahi
Ardian Mullahi

Ardian Mullahi

STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"MEDIASHOP" Sh.p.k.



Ortake e shoqerise "MEDIASHOP" SH.P.K. eshte:
Ardian Mullahi, lindur me 1966 ne Tirane, banues ne Tirane, Rruga "Qemal Stafa", Pall.341, Sh.4, Ap.48, qe ketu me poshte quhet "Ortak i Vetem" dhe qe deklaron se miraton kete statut me dispozitat e meposhtme:

KAPITULLI I

Legjislacioni, Forma

Neni 1

Shoqeria "MEDIASHOP" SH.P.K., qe ne vazhdim shkurtimisht do te quhet "shoqeria" eshte krijuar ne baze te ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare" dhe te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

Neni 2

Forma juridike e shoqerise eshte ajo e "shoqerise me pergjegjesi te kufizuar" prandaj pergjegjesia e ortakut eshte e kufizuar deri ne shumen e kapitalit themeltar, ne proporcion me pjeset qe zoterohen prej saj.

Shoqeria, pavaresisht nga objekti i veprimtarise, quhet tregtare dhe i nenshtrohet rregullave te percaktuara ne Kodin Tregtar te Republikes se Shqiperise.

KAPITULLI II

Emertimi, Selia, Kohezqiatja

Neni 3

Emertimi i shoqerise eshte :

"MEDIASHOP" Sh.p.k.

Neni 4

Selia e shoqerise eshte ne Tirane.

Shoqeria mund te hape filiale, dege dhe/ose agjensi brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Ardian Mullahi

Neni 5

Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise eshte percaktuar per nje periudhe kohe te pakufizuar por jo me pak se dhjete (10) vjet, duke filluar nga dita e regjistrimit te saj ne regjistrin e shoqerive tregtare.

KAPITULLI III

Objekti

Neni 6

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj :

Ushtrimin e aktivitetit ne fushen e publicitetit qe nenkupton pergatitjen dhe shperndarjen e materialeve publicitare ne te gjitha fushat e medias te shkruar dhe elektronike, si dhe prodhimi e tregtimi i reklamave reklamave dhe materialeve te ndryshme audio - vizive.

KAPITULLI IV

Kapitali themeltar

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqerise eshte percaktuar ne shumen 100.000 (njqindmije) leke i depozituar ne Banken e Kursimeve te Shqiperise, Dega Tirane, ne llogarine e celur ne emer te shoqerise.

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 100 pjese me nje vlere nominale te barabarte me 1.000 (njemije) leke sejcila, pjese te cilat zoterohen 100% nga Ortaku i Vetem.

Neni 8

Zmadhimi i kapitalit.

Zmadhimi i kapitalit themeltar mund te behet me vendim te jashtzakonshem te Ortakut te Vetem. Zmadhimi i kapitalit themeltar mund te behet me derdhje ne para ose me kontribute ne natyre, ne kete rast keto kontribute duhet te shoqerohen me nje raport vleresimi teknik te kryer nga nje ekspert i vleresimit te kontributeve, i emeruar nga Ortaku i Vetem dhe qe duhet t'i bashkelidhet vendimit te ketij ortaku.

Neni 9


Zvogelimi i kapitalit.

Zvogelimi i kapitalit themeltar mund te behet me vendim te jashtzakonshem te Ortakut te Vetem, me propozim te administratorit, vetem ne rastin kur shoqeria mund te pesoje humbje te tilla qe ta bejne te domosdoshem kete zvogelim.

Kapitali themeltar nuk mund te jete me i vogel se vlera minimale e caktuar me ligj, ne rast te kundert shoqeria detyrohet te ndryshoje formen juridike ose te priset.



Handwritten signature



Neni 14

Administratori shkarkohet me vendim të motivuar të Ortakut të Vetem, ose me vendim të gjykates me kerkese të Ortakut të Vetem për shkalje të ligjit.

Ne rast se shkarkimi i bere nga Ortaku i Vetem është pa arsye të drejte, ai le shteg për demshperblim financiar.

KAPITULLI VI

Te ndryshme

Neni 15

Miratimi i llogarive

Administratori brenda 3 muajve nga dita e mbyljes së vitit financiar harton dhe i paraqet Ortakut të Vetem, për miratim, raportin e administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore.

Ortaku i Vetem ka të drejtë të marrë në çdo kohë dhe kontrollojë dokumentat e mesipërme, për tre vjetet e fundit financiare, si dhe mund të ndihmohet nga një ekspert i zgjedhur prej tij, i cili i nënshtrohet detyrimit për të ruajtur sekretin profesional.

Neni 16

Veprimtaria dhe viti fiskal i shoqërise mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 17

Nga fitimi i realizuar gjatë vitit financiar, pasi të jenë zbritur të gjitha shpenzimet dhe po të jete nevojë edhe humbjet e vitit të meparshëm, lihet menjëherë një shumë me vlerë jo më pak se 5% e fitimit, e cila nevojitet për formimin e fondit rezerve që quhet "rezerva e domosdoshme", derisa kjo rezerve të arrijë të paktën sa 1/10 e kapitalit themeltar.

Pjesa tjetër e fitimit përdoret sipas vendimeve të Ortakut të Vetem.

Neni 18

Ortaku i Vetem në çdo kohë mund të vendosi prishjen e shoqërise, në vartësi të gjendjes ekonomiko-financiare apo edhe shkaqeve të tjera që atij mund t'i duken të arsyeshme, prishje e cila detyrimisht sjell një likuidim që do të bëhet sipas procedurave ligjore për likuidimin.

Neni 19

Për çfarë nuk është parashikuar në këtë statut referimi do të bëhet në dispozitat ligjore që rregullojnë këto marrëdhënie juridike.

ORTAKU I VETEM

(Ardian Mullahi)